

THIRRJE E ZYRES RAJONALE PËR BASHKËPUNIM RINOR PËR PJESËMARRJE NË TRAJNIMIN MBI PËRGATITJEN E PROPOZIMEVE PËR SHKOLLAT E MESME DHE ORGANIZATAT QYTETARE

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, shpall thirrje për pjesëmarrje në trajnim mbi ngritjen e kapaciteteve në përgatitjen e projekteve të mobilitetit, bashkëpunim dhe aktivizmit rinor në Ballkanin Perëndimor, për përfaqësues të shkollave të mesme dhe organizatave qytetare. Trajnimi do të zhvillohet nga **11 - 14 Shtator 2018, në hotelin Montana, Krushevë**.

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) është një mekanizëm i pavarur institucional, i themeluar nga palët kontraktuese në Ballkanin Perëndimor, në mënyrë që të promovojë fryshtat e pajtimit dhe bashkëpunimit mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit të te rinjve. Në kuadër të punës së vetë, RYCO mbështet projekte që kontribuojnë në pajtimin në rajon përmes rritjes së mobilitetit të rinisë, bashkëpunimit dhe aktivizmit. Duke marre parasysh këtë, që shumica e të interesuarve të kenë mundësinë për t'iu përgjigjur RYCO dhe thirrjeve të ngjashme për përgatitjen e projekteve, RYCO organizon trajnim mbi ngritjen e aftësive në këtë sferë.

QËLLIMI I TRAJNIMIT:

- Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është që të rrisë nivelin e njojurive dhe kapacitetin e organizatave qytetare dhe nxënësve të shkollave të mesme në mënyrë të pavarur dhe me sukses të bëjnë përgatitjen e propozimeve, duke respektuar parimin e pjesëmarrjes përfshirëse të të rinjve;
- Gjatë trajnimit treditor, pjesëmarrësit do të fitojnë bazën teorike si dhe mundësinë për të punuar dhe praktikuar në mënyrë të pavarur në grupe të vogla, për të zhvilluar elementet bazike në aplikimin e projekteve - fillimisht nga arsyetimi i idësë, me vendosjen e qëllimeve dhe aktiviteteve, deri në formimin e një buxheti real dhe marrëdhënieve të perpiluara mirë;
- Përveç kësaj, pjesëmarrësit do të njihen me konceptet e të mësuarit ndërkulturor, pajtimin, pjesëmarrjen e të rinjve dhe përfshirjen sociale, si dhe mundësitet për kërkim të partnerëve në rajon.

Trajnimi do të zhvillohet në gjuhën maqedonase, me përkthim në gjuhën shqipe.

Të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes (udhëtimi, vendosja, ushqimi) do të mbulohen.

PËR KËND ËSHTË TRAJNIMI: Ky trajnim është dizajnuar që përfaqësuesit e shkollave të mesme dhe organizatave qytetare të cilët nuk kanë aspak ose kanë përvojë shumë të kufizuar në përgatitjen dhe realizimin e projekteve. Më konkretisht, kriteret për pjesëmarrje janë siç vijon:

PËRFAQËSUESIT E SHKOLLAVE TË MESME	PËRFAQËSUESIT E ORGANIZATAVE QYTETARE
→ Të cilët planifikojnë të udhëheqin procesin dhe të hartojnë një propozim projekt para institucionit të tyre	→ Të cilët planifikojnë të udhëheqin procesin dhe të hartojnë një propozim projekt para organizatave të tyre
→ Cilët mund tërësish t'i përkushtohen trajnimit	
→ Ata që kurrë nuk kanë qenë bartës të ndonjë projekti rajonal	
→ Deri tani nuk kanë pasur sponsorë apo partnerë të projektit të financuar nga Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor	
→	→ Të cilët nuk kanë realizuar projekte me vlerë më të lartë se 10,000 euro
→	→ Të cilët janë të regjistruara më shkurtë se 3 vjet
! Në veçanti inkurajohen shkollat dhe organizatat nga komunitetet më të vogla dhe/ose multietnike	

SI TË APLIKONI PËR PJESËMARRJE:

Regjistrimi për pjesëmarrje zgjat nga 15 deri më 31 gusht 2018. Vetëm një person mund të aplikojë për një shkollë /organizatë. Aplikacionet bëhen duke përdorur formularin: <https://goo.gl/xDuXYL>

Përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet në bazë të kritereve të lartpërmendura, duke respektuar barazinë gjinore dhe gjeografike. Rezultatet e përzgjedhjes do të publikohen më 04 shtator 2018 dhe kandidatet e përzgjedhur do të kontaktohen përmes telefonit ose postës elektronike.

KONTAKT:

Për pyetje dhe sqarime shtesë, mund të kontaktoni z. Albert Hani, Koordinator i zyrës lokale RYCO për Shkup në albert.hani@rycowb.org

Shënim: Pjesëmarrja në trajnim nuk përfaqëson një garanci për alokimin e fondeve për zbatimin e projekt propozimeve nga RYCO.